



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2022:017670

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05432139

**C.nr.122/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Fuad Haliti, në çështjen juridike të paditësve M.H dhe B.Sh nga Mitrovica, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. Amir Bunjaku, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Arbnor Murturi, lidhur me padinë për kompensimin e ushqimit gjatë punës, jashtë seance me datë 11.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSIDEROHET** se është tërhequr padia e paditësve M.H dhe B.Sh nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, me objekt kontesti kompensim i ushqimit gjatë punës.

**Arsyetim**

Paditësit me datën 28.01.2022 kanë paraqitur padi pranë kësaj gjykatë kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore më të cilën kanë kërkuar kompensimin e ushqimit gjatë punës.

Në seancën e datës 11.03.2024 i autorizuari i paditësve Av. Amir Bunjaku nuk ka prezantuar në seancë edhe pse i njëjti ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregullt, mirëpo mungesën nuk e ka arsyetuar, ndërsa e paditura nuk ka kërkuar që seanca të mbahet në mungesë të paditësve.

Në bazë të nenit 409 paragrafi 1 i LPK-së parashihet që 1 “*Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.*”

Andaj gjykata duke u bazuar nenit 409 paragrafi 1 i LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.122/2022, datë: 11.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Fuad Haliti**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa brenda afatit prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.